



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVAT
PËRMBARUESI GJYQËSOR “LEKË DODAJ”

Adr: Rr."Astrit Balluku", Nd. 2, H. 25, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, E-mail: leke_dodaj@hotmail.com, Cel: +355 67 39 00 666

Nr. 1718 /Prot; 337-Regj

Tiranë më, 24/ 11/ 2020

U R D H Ë R
PËR HEQJE TË SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : Qendrës Kombëtare të Biznesit, Tiranë
Bulevardi “Zhan D’Ark, Nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë

Për dijeni : Shoqëria “Otofon” sh.p.k me NIPT L11824004G
Rruga “ Qemal Stafa”, nr.51, Tiranë

Unë, Lekë Dodaj Përmbaues Gjyqësor me Çertifikatë Nr.144 Mars 2013 dhe Nr NIPT L31603014T, bazuar në vënien në ekzekutim të Titullit Ekzekutiv Vendimit me nr.9038, nr. 8985 Akti të datës 05.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është lënë në fuqi me Vendimin nr.23, nr. 5841/4071/3229 Akti të datës 20.01.2020 nga Gjykata e Apelit Tiranë,

KONSTATOVA :

Se më datë 26.02.2020, pranë Shërbimit Përmbaues të Përmbauesit Gjyqësor Lekë Dodaj, është depozituar kërkesa e Palës Kreditore Mirela Cojo së bashku me Titullin Ekzekutiv Vendimi nr.9038, nr. 8985 Akti, i datës 05.11.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është lënë në fuqi me Vendimin nr.23, nr. 5841/4071/3229 Akti të datës 20.01.2020 nga Gjykata e Apelit Tiranë, me palë dhe objekt :

Kreditore : Mirela Cojo
Debitor : Shoqëria “Otofon” sh.p.k me NIPT L11824004G
Objekti : Dëmshpërblim Page

Në kushtet kur ekzekutimi i Titullit Ekzekutiv ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm dhe për ekzekutimin e tij duhet të kryhet bllokimi i pasurive në pronësi të Palës Debitor nga ana e Shërbimit Përmbaues me shkresën nr.278/prot ; 337-Regj të datës 09.03.2020 kemi urdhëruar vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi kuotat apo aksionet që zotëron Pala Debitor Shoqëria “Otofon” sh.p.k me NIPT L11824004G.

Në zbatim të Titullit Ekzekutiv Vendimit me nr.9038 të datës 05.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë , më datë 19.05.2020 Pala Debitore Shoqëria “Otofon” sh.p.k me NIPT L11824004G, ka shlyer pjesërisht detyrimin financiar në vlerën 849’699 (tetëqind e dyzet e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) Lekë, ndërsa më datë 24.11.2020 ka shlyer pjesën e mbetur të detyrimit në masën 598’988 (pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë) Lekë duke shlyer në total detyrimin financiar të përcaktuar në Titullin Ekzekutiv si dhe Tarifën e Shërbimit Përmbarimor.

Sa më sipër , të ndodhur në kushtet kur Pala Debitore Shoqëria “Otofon” sh.p.k me NIPT L11824004G ka shlyer tërësisht detyrimin financiar në favor të Palës Kreditore Mirela Cojo , sipas Titullit Ekzekutiv Vendimit me nr.9038, nr. 8985 Akti të datës 05.11.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili është lënë në fuqi me Vendimin nr.23, nr. 5841/4071/3229 Akti të datës 20.01.2020 nga Gjykata e Apelit Tiranë, dhe ndaj Titullit të Ekzekutimit të sipërcituar është marrë vendimi i pushimit, në zbatim të nenit 617 të K.Pr.Civile,

URDHËROJ:

Qëndrën Kombëtare të Biznesit, të heqë masën e sekuestros konservative mbi kuotat apo aksionet që zotëron Pala Debitore Shoqëria “Otofon” sh.p.k me NIPT L11824004G të vendosur nga ana e Shërbimit Përmbarimor me Urdhërin me nr.278/prot ; 337-Regj të datës 09.03.2020.

Për veprimet apo mosveprimet tuaja na vini në dijeni shkresërisht **brënda 10 (dhjetë) ditëve** nga marrja dijeni. Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.III) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzim penal parashikuar nga neni 320/a.

PËRMBARUESI GJYQËSOR

Lekë D. DODAJ

